



SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË
"KEKA - MED"
KLINË

Adresa: Rr. "Sadik Rama", p.n. - Klinë, 32.000 / Email: shmpkekamed@gmail.com / Kontakt: +383(0) 44/48 663001

Nr. prot: 01-1208/24

Më: 05/07/2024

Në bazë të neneve 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neneve 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik, Udhëzimit Administrativ MASHTI nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, Drejtori i shkollës shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollorë 2024-25

Institucioni i Arsimit dhe Aftesimit Profesional (IAAP) "KEKA-MED" KLINË

Nr.	Niveli/Shkolla	Pozita	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozita ve	Orë
1	SHMM "KEKA-MED" KLINË	Mësimdhënës/e për lëndët e mjekësisë	Vend i lirë	3	

1. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet si vijon:

- Formulari i aplikimit (merret në institucionin shkollorë dhe dorëzohet i plotësuar);
- Dokumenti personal kopje (letërnjoftim ose pasaporta);
- Rezumeja personale (CV);
- Diplomat e kualifikimit;
- Certifikata (certifikata në vend të diplomës mos të jetë më e vjetër se 6 muaj);
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi për provojë të punës në institucionet edukativo arsimore (nëse ka);
- Certifikata e lindjes

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e mësimdhënësit:

2.1 I punësuar i është obliguar të realizoj detyrat e punës si në vijim:

2.2. Të realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës.

2.3. Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.

2.4. Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.

- 2.5. Të tregoj respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët me të cilët punon.
- 2.6. Të respektoj autoritetin e drejtpërdrejtë të drejtorit, të cilit i raporton dhe ti kryej detyrat që mund t'ia caktojë ai. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- 2.7. Të mos kërkojë apo pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç drejtorit të shkollës.
- 2.8. Të mos e shfrytëzojë pozitën e punës për interesa private, në dobi të ndonjë pale të tret, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij.
- 2.9. Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhen me procesin e punës, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.
- 2.10. Të mbajë orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.
- 2.11. I/e punësuari/a është i/e obliguar të respektoj kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.
- 2.12. Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

3. Kushtet e punësimit:

Për këto vende pune kërkohet përgatitja adekuate në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Rep. e Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ MASHTI nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional.

Data e njoftimit është prej datës 05 Korrik 2024, deri me datën 05 Gusht 2024, **ndërsa afati i aplikimit është nga dt: 06 Gusht 2024 deri me dt: 21 Gusht 2024.**

Aplikacionet e konkurrimit merren dhe dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, ne objektin e Shkollës së Mesme të Mjekësisë "KEKA-MED" në Klinikë.

Inkurajohen të aplikojnë kandidatet e të gjitha përkatësive etnike dhe gjinore.

Në intervistë do të ftohen vetëm ata kandidat që i plotësojnë kushtet e konkursit sipas përgatitjes përkatëse ose të përafërt. Njoftimi do të bëhet me email, telefon dhe me shpallje në shkollë.

Aplikacionet e pakompletuara dhe ato të dërguara pas afatit nuk do të pranohen dhe shqyrtohen.

Të gjithë kandidatet që kanë mbaruar studimet jashtë shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga MASHTI, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidateve të cilët nuk i kanë plotësuar këto kushte të konkursit.

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës.

